



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Flori Rexhepi</b>	<b>16.04.2025</b>	<b>24.04.2025</b>	<b>2025/0267</b>

**BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT**

Me datën: 12.04.2025, OE “NOI CONSTRUCTION SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/0267, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndertimi i infrastruktures se jashtme te QKMF - Lipjan” me nr. të prokurimit: "613-25-851-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: pune, vlera e parashikuar e kontratës: 351,100.00€.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

**DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE**

--

Neni 7-Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi dhe Transparenca

Neni 10- Mjetet për promovimin e transparencës

Neni 11-Informatat Sekrete Afariste

Neni 24-Zyrtaret e Prokurimit gjatë ushtrimit të aktivitetit të prokurimit.

Neni 26 -RRUOPP Kriteret e Perzgjedhjes

Neni 28-RRUOPP Kriteret e Dhënies së Kontratës

Neni 41-RRUOPPEkzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve Neni 52 -

Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës,

Neni 59-Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Paragrafi 3

Neni 60-Kriteret përdhëniene Kontratës

Neni 69-Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale Neni

97- Shkeljet e Renda

Ligjimi nr. 06/L-081, për qasjen e dokumenteve publike

-Neni 17-Bazatë lejueshme për refuzimin e qasjes në dokumente publike.

## KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<b>Kapaciteti teknik dhe profesional:</b>	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i>
		<p><b>Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në vlerë prej 450,000.00 Euro për (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.</b></p> <p><b>Kërkesa 2. Lista e stafit a) Min Një inxhinier i ndërtimit të sistemit 5 vjeçar</b></p>	<p><b>Dëshmia 1. Një listë e kontratave të nënshkruar dhe vëlosur nga OE ku do të bëhet përshkrimi me këto informata: titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës, Referencat apo pranimin teknik kopje për kontratat e prezentuara për projekte të ngjashme. Nëse kontrata me referencë është me kompani private të deshmohet me transaksion bankar (dëshmi që është kry pagesa). Referencat apo pranimet teknike duhet të jenë në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.</b></p> <p><b>Dëshmia 2. Lista e stafit duhet të dorëzohet e nënshkruar dhe e vëlosur nga OE. a). Vendimi me shkrim mbi caktimin</b></p>

	<p>ose ( master) drejtimi konstruktiv min 5 vite pervoje pune pas diplomimit, te caktohet si menaxher i projektit. b) Min Nje inxhinier i Elektroteknikes sistemi 5 vjeqar apo master min 5 vite pervoje pas diplomimit. c) Min Nje Gjeodet bachelor apo master dhe i licencuar, licence me afat, min 5 vite pervoj pune pas diplomimit. g) Min 10 puntor.</p>	<p>e menaxherit per kete projekt i nenshkruar dhe vulosur nga OE b).Per stafin profesional te deshmohen me Diplome, CV dhe licenca e gjeodetit me afat, Per te gjith stafin kerkohen Kontratat e punes, ose parakontratat e punes me validitet dhe kohegjatje te kete projekti. Per diplomat e fituara jashte Republikes se Kosoves kerkohen qe te jene te Nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Republika e Kosoves</p>
	<p>Kerkesa 3. Lista e pajisjeve teknike a) Eskavator min 20 T = (min 1 copë), b) Eskavator min 10 T = (min 1 cope), c) Eskavator me rrota gome min 20 T = ( min 1 cope), d) Luge ngarkuese min 20 T = (min 1 copë), e) Luge ngarkuese max 2 T = (min 1 copë), f) Cilinder per ngjeshjen min 10 T = (min 2 cope), g) Cilinder per ngjeshjen max 3 T = (min 1 cope), h) Eskavator max 1 T = (min 1 cope) i) Greider min 15 T = (min 1 cope), j) Finisher min 6 T = (min 1 cope), k) Dumper max 5 T = (min 1 copë), l) Gersher per demolim betoni dhe prerese e cila montohet ne eskavator min 5 T =(min 1 cope) m) Kamion auto kran = (min 1 cope), n) Auto Shporte = ( min 1 cope), o) Kamion kiper = (min 3 copë)</p>	<p>Deshmia 3. Lista e paisjeve e nenshkruar dhe vulosur nga OE, per automjetet qe nuk regjistrohen Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes, Për automjetet qe regjistrohen Librezat e qarkullimit me validitet. Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë OE duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve me deshmite sipas kerkeses me larte. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të këtij projekti e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët.</p>

## RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit , komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues është i papërgjegjshëm.

OE i rekomanduar per kontratë është i përgjegjshëm.

## INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

#### VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

#### VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

#### ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

#### PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - NOI CONSTRUCTION SH.P.K.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues NOI CONSTRUCTION SH.P.K. i pakënaqur me vendimin e AK-KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN, ka parashtruar ankese ne OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kryesisht dispozitat e nenit 59 te LPP-se.

Pas përfundimit te vlerësimit te ofertave AK- KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN, e njofton OE ankues lidhur me arsyet e eliminimit, te cilin e eliminon me arsyetimin si me poshtë:

1. Tek kërkesa 2, është kërkuar a) Min Nje inxhinier indertimtarise sistemi 5 vjeqar ose (master) drejtimi konstruktiv min 5 vite pervoje pune pas diplomimit, Inxhinieri juaj qe keni dorzuar ne kete dosje ka diplomuar ne vitin 2022 ne baze te diplomes se dozuar dhe nuk ka arritur 5 vite pervoj pune pas diplomimit.
2. Tek deshmia 2. është kërkuar Per te gjith stafin kerkohen Kontratat e punes, ose parakontratat e punes me validitet dhe kohesgjatje te kete projekti. Juve keni dorzuar kontratat e punes per nje pjese te stafit te kerkuara jane 10 per puntoret kurse te dorzuara jane 7 kontrata, por duhet te ju njoftojme qe te gjitha kontratat e dorzuara te puntorve dhe nje pjese stafit profesional jane te mangeta dhe te pa plotesuara ne baze te ligjit te punes sepse ju mungojne fillimi dhe perfundimi i punes po ashtu nuk eshte e cekur ne kontrate edhe paga baze per secilin puntor apo staf te kompanise.
3. Tek kërkesa 3, është kërkuar pika l) Gersher per demolim betoni dhe prerese e cila montohet ne eskavator min 5 T =(min 1 cope), Juve keni dorzuar nje dokument Dud doganor per nje eskavator dhe te dhenat per eskavator dhe ne te jane te paraqitura edhe nje leter shtese me disa paisje ne ato paisje figurojn edhe do gersher per demolim betoni por nuk ploteson kerkesen e AK siq eshte kërkuar ne NJK dhe DT sepse kerkese e AK ka qene “Gersher per demolim betoni dhe prerese e cila montohet ne eskavator min 5 T” deshmia e dorzuar eshte jashte kerkeses se AK.

4. Tek kërkesa 3, është kërkuar pika h) Eskavator max 1 T, për këtë kërkesë ju keni dëshmuar me dud doganor në të cilin mungojnë të dhënat për pronarin e paisjes, nuk ka asnjë të dhënë se kujna i përket kësaj paisjeje në dud doganor.

### **Pretendimi nr. 1**

Lidhur me arsyen e pare të eliminimit, ku autoriteti kontraktues e ka eliminuar se inxhinieri i ndërtimtarisë – konstruktive, i prezantuar në oferte nuk e plotëson pevojen e punës (5 vjeqare), me arsyetimin se ka diplomuar në vitin 2022 dhe nuk e arrin përvojën 5 vjeqare, eksperti shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues të kërkesa nr. 2 e dosjes së tenderit ka kërkuar:

Kërkesa 2: Një inxhinier i ndërtimtarisë sistemi 5 vjeqar ose (master) drejtimi konstruktiv, min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të caktohet menjëherë i projektit.

Eksperti shqyrtues, pas analizimit dhe shqyrtimit të të gjitha provave sqaron se OE ankues në ofertën e tij ka prezantuar pjesë të stafit ( H. K) Inxhinier i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv, i njëjti inxhinier me vendim është caktuar edhe menjëherë i projektit. Eksperti shqyrtues sqaron se arsye e eliminimit nga autoriteti kontraktues nuk qëndron sepse Inxhinieri i ndërtimtarisë-konstruktiv, e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit dhe njëherit sqaron se për të njëjtin janë prezantuar diplomën e cila dëshmon përfundimin e studimeve me datën 27/10/2006, dhe referuar CV-se, listës së projekteve si dhe referenca të mjaftueshme të cilat dëshmojnë përvojën profesionale pas diplomimit. Andaj eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues është i bazuar.

### **Pretendimi nr. 2**

Lidhur me arsyen e dytë të eliminimit ku autoriteti kontraktues pretendon se kontratat e prezantuara të punëtorëve, nuk janë në përputhje me ligjin e punës, eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron ky arsyetim i AK-se, për arsye se mbi bazën e dëshmi të dorëzuar AK, mundet që konform dispozitave ligjore të nenit 72 të LPP-se të kërkojë sqarime shtesë lidhur me dëshmitë e prezantuara dhe njëherit sqarojë se nuk mund ta eliminojë për një kërkesë e cila nuk është vendosur në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Konkretisht autoriteti kontraktues, i ka kërkuar gjithsej 13 staf/punëtorë për realizimin e këtij projekti ndërsa OE ankues i ka prezantuar gjithsej 13. Andaj, siç u sqarua edhe më lartë mbi bazën e listës së stafit dhe eventualisht ndonjë dyshim tjetër AK, mund të kërkojë sqarime shtesë lidhur me kontratat e punëtorëve të prezantuar në listën e stafit-punëtorëve.

### **Pretendimi nr. 3**

Lidhur me arsyen e tretë të eliminimit, ku autoriteti kontraktues ka konstatuar se: të kërkesa nr. 3, është kërkuar pika 1) gersher për demolim betoni dhe prerës e cila montohet në ekskavator min 5 T –( min 1 cop), juve keni dorëzuar një dokument Dud doganor për një ekskavator dhe

te dhënat për ekskavator dhe ne te jen te paraqitura edhe nje letër shtes me sisa pajisje ne ato pajisje figuron edhe do gersher për demolim betoni por nuk plotësohet kërkesa e AK si eshte kërkuar ne NJK dhe DT sepse kërkesa e AK ka qene” gersher për demolim betoni dhe prerese e cila montohet ne ekskavator min 5 T, dëshmia e dorëzuar është jashtë kërkesës se AK.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, ne ankesen e tij e pranon se nuk e ka ngrakuar marreveshjen me te cilen e ka marrr me qera nga OE Dani EDR Sh.p.k, pajisjen gersher per demolim betoni dhe prerese e cila montohet ne eskavator.

Lidhur me kete pretendim eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ne oferten e tij, konkretisht ne listen e pajisjeve, ne piken nr: 13 te listes se pajisjeve e ka prezantuar pajisjes ne fjale, ndersa s ai perket mungeses se deshmive per kete pajisje, autoriteti kontraktues eshte dashur qe konform dispozitave të nenit 59 dhe 72 të LPP-se të kerkoje sqarime shtese.

#### **Pretendimi nr. 4**

Lidhur me arsyen e katert te eliminimit, ku AK e eliminon me arsyetimin se të dhenat/deshmit e pronesiese ne Dud-in doganor, pra siaps AK nuk ka te dhena lidhur me pronarin e pajisjes.

Eksperti shqyrtues, sqaron se lidhje me pajisjen eskavatore max. 1t, perveq Dud-it doganor, OE ankues e ka dorezuar edhe faturen e blerjes me te cilen deshmohet pronesia, megjitheate AK, ka mundur te kerkoje sqarim shtese per dyshimet eventuale qe ka pasur.

#### **Pretendimi nr. 5**

OE ankues, ne anksen e tij pretendon se i rekomandauri per kontrate, ka dorezuar deshmine pajisjes gersher per demolim betoni dhe prerese e cila montohet ne eskavator te nje kompanie tjeter, sepse sipas OE ankues, OE i rekomanduar per kontrate Begisholli Company ka nr unik: 810134627, ndersa dud-i doganor i dorezuar ne oferte i perket N.T.P Begisholli me nr unik: 810638463.

Ekseprti shqyrtues, lidhur me kte pretendim sqaron se nuk qendron per arsye se i rekomanduari per kontrate Begisholli Company ka nr unik: 810134627 e ka dorezuar edhe marreveshjen per shfrytezimin e pajisjes me OE N.T.P Begisholli me nr unik: 810638463. Ndersa sa i perket pretendimit te OE ankues dhe dyshimit të tij se Dud-i doganor eshte manipuluar sepse sipas te dhenave rezultojne tjera specifika te pajisjes, ekseprti shqyrtues, i

rekomandon Autoritetit Kontraktues qe gjate rivlersimit ta verifikojë deshmin ne fjale.

#### REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.



Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “NOI CONSTRUCTION SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF - Lipjan” me numër të prokurimit: “613-25-851-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **NOI CONSTRUCTION SH.P.K.**

**Florije Rexhepi**

